

# KONVENTA E STAMBOLLIT BAZOHET NË KATËR SHTYLLA:

Konventa e Këshillit të Evropës për  
Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës  
ndaj Grave dhe Dhunës në Familje



**PARANDALIMI**



**MBROJTJA**



**NDJEKJA PENALE**



**POLITIKAT E  
BASHKËRENDUARA**

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

# PARANDALIMI

Nëse një vend e ka ratifikuar Konventën e Stambollit, duhet t'i ndërmarrë masat e mëposhtme:

## **Inkurajimi i mediave dhe sektorit privat**

Në vendosjen e standardeve që rrisin rolet respektuese gjinore dhe sfidojnë qëndrimet që justifikojnë dhunën ndaj grave



## **Fushata ndërgjegjësimi**

Ngritja e vetëdijes për format e ndryshme të dhunës, natyrën e tyre shkatërruese dhe ndikimin që ato kanë tek gratë dhe fëmijët



## **Edukimi në jo-dhunë dhe barazi midis grave dhe burrave**

Përfshinë materiale mësimore mbi barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore, zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve dhe të drejtën për integritet personal në kurrikulat zyrtare në të gjitha nivelet e arsimit





### Sfidimi i stereotipeve gjinore

Promovon ndryshime në format sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave



### Promovimi i fuqizimit të grave

Prezantimi i programeve dhe aktiviteteve për fuqizimin e grave dhe adresimi i nevojave specifike të njerëzve në situata të cenueshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut



### Programet për kryerësit e veprave të dhunës

Krijimi i programeve për t'i mësuar kryerësit e veprave të dhunës në familje për të adoptuar sjellje jo të dhunshme dhe autorët e veprave penale seksuale për t'i shmangur përsëritjet e veprave penale seksuale



### Roli i burrave dhe djemve

Inkurajimi i angazhimit dhe kontributit aktiv nga burrat dhe djemtë në parandalimin e dhunës



### Trajnimi i profesionistëve

Trajnimi i profesionistëve që punojnë me viktime ose kryerësit e veprës së dhunës për të njohur dhe reaguuar ndaj dhunës dhe të bëjnë rekomandime të përshtatshme



# MBROJTJA

Siguria dhe nevojat e viktimave dhe dëshmitarëve duhet të jenë në zemër të të gjitha masave mbrojtëse të miratuara nga një vend.

Këto të drejta përfshijnë:

## Informacionin mbi të drejtat e tyre

Viktimat duhet të informohen për të drejtat e tyre dhe të dinë se ku dhe si të marrin ndihmë në gjuhën që ata kuptojnë



## Shërbimet mbështetëse

Viktimat duhet të kenë qasje në shërbimet e specializuara për mbështetje të grave, të cilat shpesh janë gra-për-gra dhe janë të dedikuara për lloje specifike të dhunës. Viktimat gjithashtu duhet të kenë qasje në shërbime të përgjithshme si p.sh. këshilla /ndihmë juridike, këshilla psikologjike, ndihmë financiare, strehim, arsimim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale dhe ndihmë për gjetjen e punës



## Mekanizmat rajonalë dhe ndërkombëtarë të ankesave

Viktimat duhet të informohen dhe të kenë qasje në mekanizmat përkatës rajonalë dhe ndërkombëtarë të ankesave



## Strehimoret

Viktimat duhet të kenë qasje në një strehimore lokale, lehtësisht të qasshme për gratë dhe fëmijët



## Qendrat e krizave të dhunimit ose të dhunës seksuale

Viktimat duhet të kenë qasje në një qendër të afërt lehtësisht të qasshme duke siguruar këshillim të menjëhershëm mjekësor, kujdes për traumat dhe shërbime mjeko-ligjore





### Raportimi i dhunës tek autoritetet

Të gjithë duhet të inkurajohen që të raportojnë aktet e dhunës tek autoritetet përkatëse për të parandaluar incidente të mëtejshme, dhe rregullat e konfidencialitetit nuk duhet t'i parandalojnë profesionistët të bëjnë një gjë të tillë, kur kjo arsyetohet



### Urdhër ndalimet emergjente

Këto do t'i japin policisë autoritetin për të larguar kryerësin e veprës së dhunës në familje nga shtëpia e tyre për një periudhë të caktuar kohore dhe t'i urdhërojnë ata të qëndrojnë larg viktimës



### Urdhër mbrojtjet ose kufizimet

Ato duhet të jenë lehtësisht të arritshme për mbrojtje të menjëhershme ndaj viktimës pa ndonjë kosto



### Të drejtat e kujdestarisë dhe vizitave të sigurta për fëmijët

Nëse ekziston një histori dhune, vendimet për kujdestarinë dhe vizitën duhet t'u japin përparësi të drejtave dhe sigurisë së fëmijës dhe viktimës



### Linjat ndihmëse telefonike falas 24/7

Viktimat duhet të kenë qasje në një linjë ndihmëse telefonike konfidenciale falas në të gjithë vendin 24/7 duke u ofruar atyre këshilla



### Të drejtat dhe nevojat e dëshmitarëve fëmijë

Interesi më i mirë i fëmijëve dëshmitarë të dhunës duhet të merret në konsideratë dhe të sigurohet këshillimi psikosocial i duhur adekuat për moshën e fëmijës



# NDJEKJA PENALE

Nëse një vend e ka ratifikuar Konventën e Stambollit, duhet të sigurojë:

## Zbatimin e ligjit dhe procedurat gjyqësore

### Sanksione bindëse për kruerësit e veprës së dhunës

Të sigurohet që veprat penale dhe shkeljet e urdhrave të mbrojtjes do të jenë shkak i sanksioneve penale proporcionale ose ligjore, përfshirë burgosjen, ekstradimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen, dhe tërheqjen e të drejtave prindërore



### Ndjekje penale efektive publike

Hetimi ose ndjekja penale e veprave të dhunshme ndaj grave do të marrë parasysh që gratë preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna; nuk do të varet nga një raport ose ankesë nga viktima dhe madje mund të vazhdojë nëse viktima tërheq deklaratën ose ankesën e vet



### Marrje parasysh të rrethanave rënduese

Të sigurohet që rrethanat rënduese të merren parasysh, përfshirë viktimën që është në lidhje intime ose të ngushtë, krimet ndaj një personi të cënueshëm ose në prani të një fëmije, në përplasje me njerëzit e tjerë, nivelet ekstreme të dhunës ose dëmtimit psikologjik, kërcënimin me armë, etj. ose dënimet e mëparshme për krime të një natyre të ngjashme



### Legjislacion që e penalizon dhunën ndaj grave

Krijimi i ligjeve që penalizojnë dhunën fizike, psikologjike dhe seksuale, ngacmimin seksual, përndjekjen, gjymtimin e organeve gjentiale të grave, martesën e detyruar, abortin e detyruar dhe sterilizimin e detyruar. Shtetet palë do të sigurojnë që kultura, tradita ose i ashtuquajtur 'nderi' nuk konsiderohen justifikim për dhunën



### Hetim efektiv policor

Agjencitë e zbatimit të ligjit do të duhet t'i përgjigjen menjëherë thirrjes për ndihmë, t'i menaxhojnë situatat e rrezikshme siç duhet, dhe t'i hetojnë të gjitha pretendimet e dhunës ndaj grave



# Të drejtat e viktimave



## Mbrojtje të viktimave dhe dëshmitarëve fëmijë

- Fëmijëve do t'u sigurohen masa mbrojtëse të përshtatshme dhe të veçanta
- Fëmijët viktimë të dhunës seksuale, martesave të detyruara, gjyktimit të organeve gjenitale femërore dhe abortit ose sterilizimit të detyruar, do të jenë në gjendje të iniciojnë veprim juridik për një kohë të mjaftueshme pasi ta kenë arritur moshën madhore



## Vlerësime të bashkërenduara të rrezikut

Do të kryhen në bashkëpunim me agjencitë dhe institucionet përkatëse, duke marrë parasysh veprat e përsëritura dhe qasjen në armë zjarri, si dhe çdo informacion të ri që hetimi mund të nxjerrë në dritë



## Nuk ka fajësim të viktimave

Hetimet dhe proceset gjyqësore do t'i respektojnë viktimat në të gjitha fazat dhe nuk do të shfaqin qëndrime, sjellje dhe praktika që fajësojnë viktimat dhe u shkaktojnë atyre shqetësime shtesë



## Të drejta të viktimave për privatësi

- Sigurohuni që privatësia dhe imazhi i viktimës të mbrohet, dhe se kontakti ndërmjet viktimës dhe kryerësve të dyshuar të krimit të shmanget aty ku është e mundur
- Viktimave do t'u mundësohet të dorëzojnë prova dhe t'i paraqesin nevojat dhe shqetësimet e tyre direkt ose përmes një ndërmjetësi
- Viktimave do t'u mundësohet të dëshmojnë në sallën e gjyqit përmes teknologjive të komunikimit, ose të paktën jo në prani të autorit të dyshuar të krimit
- Historia seksuale e viktimës do të lejohet vetëm në procedurat civile ose penale, kur është e rëndësishme dhe e nevojshme



## Të drejta të viktimave për informacion dhe mbështetje

- Të informohen për progresin dhe rezultatin e rastit të tyre
- Qasje në informacionin mbi të drejtat e viktimës dhe shërbimet e përshtatshme mbështetëse për t'i ndihmuar ata t'i përfaqësojnë ato të drejta dhe interesa
- Mbështetje dhe ndihmë nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe këshilltarët e dhunës në familje gjatë hetimit dhe procedurave gjyqësore
- E drejta për asistencë juridike dhe ndihmë juridike falas
- Sigurimi i interpretëve/përkthyesëve të pavarur dhe kompetent nëse është e nevojshme
- Mbështetje ligjore për të kërkuar kompensim nga kryerësit e veprës së dhunës dhe mbështetje për t'i paditur autoritetet shtetërore nëse ata kanë dështuar në detyrat e tyre parandaluese dhe mbrojtëse



## Mbrojtje të viktimave gjatë hetimit dhe procedurave gjyqësore

- Viktimat e dhunës dhe familjet e tyre do të mbrohen në të gjitha fazat e hetimit dhe procedurave gjyqësore nga presioni, frikësimi, hakmarrja dhe viktimizimi i përsëritur
- Opsionet alternative për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet siç është ndërmjetësimi midis viktimës dhe kryerësit të veprës nuk do të jenë të detyrueshme
- Viktimat do të informohen për çdo arratisje ose lirim të autorit të krimit



# POLITIKAT E BASHKËRENDUARA

Nëse një vend e ka ratifikuar Konventën e Stambollit, duhet t'i ndër marrë veprimet e mëposhtme:

## Bashkëpunimi ndër-agjenci

Sigurimi që ekzistojnë mekanizmat e duhur që ofrojnë një bashkëpunim efektiv midis gjyqësorit, prokurorëve publik, agjencive të zbatimit të ligjit, autoriteteve lokale dhe rajonale dhe OJQ-ve




## Mbështetja dhe puna me shoqërinë civile dhe OJQ-të

Ato duhet të përfshihen së bashku me organet shtetërore si partnerë me rëndësi në zbatimin e Konventës së Stambollit



## Bashkërendimi i veprimit dhe monitorimi i zbatimit

Krijimi ose caktimi i një organi shtetëror për ta mbikëqyrur bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Konventës së Stambollit







### Politika të bazuara në të drejtat e njeriut

Vendosja e ligjeve të përqendruara në viktime për t'i parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave



### Reagimi gjithëshoqëror

Konventa e Stambollit dërgon një mesazh të qartë për shoqërinë në tërësi. Të gjithë duhet ta kuptojnë se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje nuk do të tolerohet



### Financimi i politikave dhe shërbimeve

Financimi adekuat i gjithë partnerëve të përfshirë në zbatimin e Konventës së Stambollit, përfshirë organizatat joqeveritare




### Legjislacioni gjithëpërfshirës dhe politika me ndjeshmëri gjinore

Krijimi i ligjeve dhe masave mbështetëse për t'i parandaluar të gjitha llojet e dhunës të përfshira në këtë konventë



### Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave

Grumbullimi dhe organizimi i të dhënave dhe kryerja e hulumtimeve për paraqitjen e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe efektivitetin e masave të tyre, të cilat do të ndahen me publikun, dhe agjencitë e ngjashme në vendet e tjera, për krahasim dhe për ta inkurajuar bashkëpunimin



[www.coe.int/conventionviolence](http://www.coe.int/conventionviolence)

SQI

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 46 shtete anëtare, duke i përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE